

VENDIM
Nr. 332, datë 4.5.2016

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS KOMBËTARE
PRITËSE PËR AZILKËRKUESIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS KOMBËTARE PRITËSE PËR AZILKËRKUESIT

1. Qendra Kombëtare Pritëse për Azil-kërkuesit, në vijim “QKPA”, organizohet dhe funksionon si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit për çështjet e azilit dhe të refugjatëve, në vijim ministri, me seli në Tiranë.

2. Në këtë qendër akomodohet edhe i huaji, të cilit i është refuzuar aplikimi për azil, derisa të mbarojnë procedurat e ankimit apo afatet për ushtrimin e tyre.

3. QKPA-ja ka buxhetin e vet, i cili është pjesë e buxhetit të ministrisë që mbulon çështjet e azilit dhe të refugjatëve.

4. Drejtori i QKPA-së është drejtuesi i institucionit, i cili emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga ministri dhe ka këto përgjegjësi:

a) Përfaqëson QKPA-në në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin, funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së Qendrës;

b) Zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të QKPA-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgatit projektbuxhetin për vitin e ardhshëm, të cilin ia përcjell ministrit;

c) Bashkëpunon me organe homologe dhe organizata të ndryshme të huaja për zgjidhjen efektive të problemeve, si dhe veprimtari të tjera për plotësimin e detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”;

ç) I raporton periodikisht drejtpërdrejt ministrit për kushtet e azilkërkuesve të akomoduar në këtë Qendër.

5. Përzgjedhja e programeve pedagogjike e edukuese, si dhe këshillimi ligjor falas për kategorinë e personave që trajton kjo qendër bëhen sipas legjislacionit për prokurimin publik.

6. Azilkërkuesit janë subjekte përfitimi të strehimit, ushqimit dhe të ndihmës financiare për nevoja emergjente vetjake, që ofron kjo qendër, si dhe të ndihmave humanitare, të cilat jepen nga persona fizikë ose juridikë, shqiptarë ose të huaj.

7. Mënyra dhe kriteret për përfitimin e strehimit, të ushqimit dhe të ndihmës financiare e humanitare, si dhe masa e këtyre ndihmave, sipas parashikimit të bërë në pikën 6, të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

II. STEMA DHE VULA ZYRTARE E QENDRËS KOMBËTARE PRITËSE PËR AZILKËRKUESIT

1. QKPA-ja identifikohet me stemën dhe vulën zyrtare.

2. Stema e QKPA-së përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet:

“Republika e Shqipërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit”.

3. Vula e QKPA-së prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të QKPA-së rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
 2. Struktura dhe organika e QKPA-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.
 3. Rregullorja e brendshme e QKPA-së miratohet me urdhër të ministrit.
 4. Vendimi nr. 262, datë 23.4.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, në Babrru, Tiranë, Ministrisë së Rendit Publik, si dhe për organizimin e funksionimit të saj dhe për një shtesë në numrin e parashikuar të punonjësve të kësaj ministrie”, shfuqizohet.
 5. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama